



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës , Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall konkurs:

VOZITËS

Kontrata: Vendore me orar të plotë

Vendi i Punës: Zyra Qëndrore- Prishtinë

Grada - Hapi: 6-11

Departamenti: Administratë

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë : Zyrtari i Lartë i Administratës

Numri i Referencës: 01 / 2018

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Detyra e vozitësit është të merr detyrat e vozitjes sipas caktimit si pjesë e Njesisë të Transportit.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Punon nën mbikëqyrjen e Zyrtarit të Lartë të Administratës të Agjencisë së Privatizimit;
- Vozitë dhe mirëmban makinat të cilat janë pronë e Agjencisë së Privatizimit ose makinat tjera të angazhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
- Detyrat do të përfshijnë transportin e personelit dhe mallrave sipas udhëzimit nga Menaxhmenti;
- Mban evidencën e servisimit të veturave;
- Mban evidencën e regjistrimit të veturave si dhe kontrollimit teknik të veturave;
- Bën kontrollimin e shpenzimit të derivateve si dhe kontrollimin e kilometrave të kaluar;
- Mbledhë dokumentacionin dhe fletë-udhëtimet si dhe të njëjtat ia dorëzon zyrtarëve të cilët drejtojnë veturat motorike;
- Kontrollon përdorimin e veturave zyrtare;
- Siguron që të gjitha rregullat dhe rregulloret janë zbatuar në rast të aksidentit ose prishjes së makinës;
- Kryen detyrat tjera të caktuara nga mbikëqyrësi;

PËRGADITJET PROFESIONALE / KUALIFIKIMET/ SHKATHTËSITË

- Diplomë e Shkollës së mesme;
- Patentë shoferin në kategorinë B së paku tre (3) vite të vjetër;
- Përvojë pune një (1) vjeçare si vozitës;

- I gatshëm të vozis në të gjitha kushtet e motit dhe trafikut;
- Shkathtësi rreth riparimeve të vogla;
- Njohuri të mbrojtjes personale dhe njohuri mbi sigurimin;
- Eksperiencë rajonale: Njohje e mirë e gjeografisë së Kosovës;
- Shkathtësitë personale: gjendje të mirë fizike, i motivuar, një planifikues i avancuar dhe i mirë në punë nën presion;
- Të jetë një entuziast dhe i aftë për të punuar;
- Fleksibilitet dhe gatishmëri të punoj orar të zgjatur;
- Njohja e gjuhës serbe e preferuar;
- Të mos ketë dosje penale (vërtetim nga gjykata kompetente);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Përshkrimi i detajuar i vendit të punës së bashku me aplikacionin për punë mund të gjenden në:

www.pak-ks.org

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të AKP-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi posedimin 3 vjeçar të patent shoferit kategoria B;
- Dëshmi mbi përvojën e punës si vozitës;
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime;

Dokumentet e kërkuara i dërgoni në e-mail adresën: **recruitment@pak-ks.org**

Titulli i e-mailit tuaj duhet të përmbajë pozitën për të cilën ju aplikoni.

“Agjencia Kosovare e Privatizimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komuniteti jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

Data e fundit për aplikim është: 21 Janar 2018 ora 16:00

Dokumentet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

Ne i falënderojmë të gjithë kandidatët për aplikim, por vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.